

INVESTIMI


Projekt ambicioz i qeverisë shqiptare, i mbës

# FSHZH nis zbatimin e projektit për rrugët dytësore dhe lokale

Oketa: "Komponentët kryesorë të këtij projekti do të jenë përmirësimi i seksioneve prioritare të rrjetit dytësor dhe lokal të rrugëve në gjithë Shqipërinë, futja e kontratave të mirëmbajtjes, duke kontraktuar sektorin privat për rrjetin lokal të rrugëve, fuqizimin e organizmave përgjegjës për manaxhimin e rrjetit rrugor lokal dhe konsolidimin e përgjegjësive institucionale për manaxhimin dhe planifikimin nga sektori i rrugëve sekondare"

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, prezantoi dje në Tiranë, fillimin e zbatimit të projektit të ri që financohet nga Banka Botërore me vlerë 400 milion USD, për ndërtimin e rrugëve dytësore dhe lokale në Shqipëri. Në konferencën e organizuar me këtë rast mori pjesë zëvendëskryeministri Gazmend Oketa, në cilësinë e kryetarit të bordit të FSHZH-së, Drejtori i programit të transportit të Bankës Botërore, Martin Humphreys, si edhe përfaqësues të tjerë të qeverisjes qendrore dhe lokale. Në fjalën e tij, zv/kryeminis-

tri Oketa prezantoi projektin, si dhe vlerësoi mbështetjen e Bankës Botërore për zbatimin e projekteve të tilla. Oketa tha se, "ky është një projekt ambicioz i qeverisë shqiptare i mbështetur nga BB dhe që do të realizohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Me anë të këtij projekti qeveria do të synojë të rrisë përpjekjet konkrete për përmirësimin e infrastrukturës në vend si edhe për shtimin e aksesit ndaj shërbimeve themelore dhe tregjeve ekonomike, veçanërisht në zonat rurale". Në fund të këtij projekti, i cili do të zgjasë 5 vjet, parashikohet të



ngrihet jo vetëm një rrjet dytësor dhe komunal i përmirësuar në mënyrë rrënjësore, por edhe një inventar i rifreskuar i të gjitha rrugëve rajonale, duke mundur të njohjen në kohë reale të nevojave për investim dhe për mirëmbajtjen e tyre. Zv/kryeministri Oketa tha se, komponentët kryesorë të këtij projekti do të jenë përmirësimi i seksioneve prioritare të rrjetit dytësor dhe lokal të rrugëve në gjithë Shqipërinë, futja e kontratave të mirëmbajtjes, duke kontraktuar sektorin privat për rrjetin lokal të rrugëve, fuqizimin e organizmave përgjegjës për manaxhimin e rrjetit rrugor lokal, dhe konsolidimin e përgjegjësive institucionale për manaxhimin dhe planifikimin nga sektori i rrugëve sekondare. Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar

të Zhvillimit, Benet Beci, foli rreth aktiviteteve kryesore dhe hapat e ardhshëm për fillimin e punës. Objektivi i FSHZH-së është lidhja e kontratave të para të punimeve civile në periudhën Korrik-Qershor 2008. I gjithë projekti do të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me Njësitë e Qeverisjes Vendore. Sipas Becit, kriteret kryesore për përzgjedhjen e projekteve për financim do të përfshijnë: "ndikimin e projektit në zhvillimin social e ekonomik të zonës, gjendja ekzistuese e rrugës së propozuar, numri i përfituesve, raporti financiar kosto/përfitim; etj". Kriteret do të bëhen publike para vlerësimit dhe do të konsultohen me të gjithë të interesuarit në mënyrë që të arrihet një përzgjedhje sa më e mirë.